

MBI AUDITIMIN E USHTRUARNË DEGËN E DOGANËS TRE URAT, PËRMET

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës Tre Urat, Përmet, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2013 - 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 199, date 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 963/7, datë 06.01.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Klajdi Naçi Kryetar i Degës së Doganës Tre Urat, Përmet dhe zj. Elisa Spiropali Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë.

Kontroli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Vendimmarrës referuar rekomandimeve të KLSH nga auditimi i mëparshëm, të dërguara me shkresën nr. 417/6 prot. datë 17.06.2013 nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e auditit të mëparshëm, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditit të mëparshëm të KLSH.

Menjëherë

2. Nga auditimi i procedurave doganore të mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike u konstatuan sasi mallrash të pa rieksporuara, për të cilat nga Drejtoria e Kontrollit të Pas Zhdoganimit në DPD, është ushtruar kontroll në bazë të Program Kontrollit nr. 23310, datë 06.10.2014, rezultatet e të cilit u paraqitën në fund të auditimit dhe rezultoi konstatim i njëjtë me KLSH për shkelje doganore për 2 raste në shumën totale 617,417 lekë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat në vijim të procedurave të marrë masa për nxjerrjen e vendimeve administrative, kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, për subjektin shpk me NIPT në vlerën **617,417 lekë**.

Menjëherë

3. Nga auditimi rezultoi se borxhi doganor është shtuar me 65 raste ose 240 %, ndërsa në vlerë është shtuar me 18,762 mijë lekë ose 38 %, dhe gjatë auditimit të procedurave të rikuperimit të tij, disa masa kanë rezultuar jo efektive, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të ndërmarrë hapat e duhur ligjor në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese apo të krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e Borxhit Doganor.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i të ardhurave rezulton se nuk ka një planifikim apo ndjekje të këtij treguesi, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për një planifikim të saktë të ardhurave sipas zërave me qëllim ngritjen në një nivel më të lartë të realizimit të objektivave në fushën e realizimit të ardhurave.

Në vijimësi

5. Nga auditimi i arkiv protokollit rezulton se nga ana e punonjësve të emëruar si sekretar-arkiv nuk është ushtruar për asnjë ditë detyra funksionale edhe pse listë prezencat për këta punonjës janë plotësuar të plota nga Autoriteti Doganor si dhe pagat janë marrë të plota, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për kryerjen e një analize të detajuar për problemin e konstatuar duke nxjerrë përgjegjësitë si dhe vlerat monetare në dëm të buxhetit të Shtetit në qoftë se do rezultojnë të tilla.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Dega e Doganës Tre Urat të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **6,375,123 lekë**; në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Dega Doganore në zbatim të ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 rezultoi se gjatë auditimit janë konstatuar raste me mallra akcize të padeklaruara, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 2 raste, në vlerën **2,030,000 lekë** sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarimin e mallrave, rezultuan raste të keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe trajtim me MSABE me nivel të taksës doganore 0 % për artikuj që nuk plotësojnë kriteret, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 31 raste, në vlerën **1,449,378 lekë** sipas aneksit nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Nga auditimi i dokumentacionit për të ardhurat dytësore rezultuan mungesë arkëtimesh klasifikuar në llogarinë Nr. 7110118 të Buxhetit të Shtetit, në lidhje me tarifatat e parkimit doganor për mjetet të cilat gjatë procedurave doganore qëndrojnë në parkingun e degës doganore, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga 2 punonjës, në vlerën **990,000 lekë** sipas aneksit nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

4. Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet rezultoi se një automjet është përdorur jashtë nevojave funksionale të degës doganore, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga 2 punonjës, në vlerën **749,250 lekë** sipas aneksit nr. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Nga auditimi i dokumentacionit për autorizimet e përjashtimeve nga detyrimet doganore rezultoi se janë lëshuar autorizime për individë pa plotësuar kriteret e ndryshimit të rezidencës së banimit, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 47-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 18 raste, në vlerën **741,049 lekë** sipas aneksit nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

6. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra nga Autoriteti Vendimmarrës janë marrë vendime me minimumin e penaltetit edhe pse subjekti shkelës ka qenë përsëritës si dhe nuk janë marrë vendime për çdo shkelje në veçanti, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 34-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për amendimin e Vendimeve Administrative dhe të zbatojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 2 raste, në vlerën **314,371 lekë** sipas aneksit nr. 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me shpenzimet udhëtime dhe dieta, janë dhënë dieta për shërbime pa dokumentacionin bashkëlidhur për qëllimin dhe afatet e shërbimit, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga z., për 21 ditë në vlerën **52,500 lekë**.

Menjëherë

8. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkiv-protokollin rezultoi një subjekt me shkelje të afateve të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim vjeljen e borxhit doganor në vlerën **48,575 lekë**.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

1. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga agjencia doganore me përfaqësues z., e cila operon pranë Degës së Doganës Tre Urat, janë keqklasifikuar artikuj me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.3 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Tre Urat, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të marrë masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, për penaltet në masën **nga 50,000 lekë deri në 200,000 lekë**, për agjencinë doganore me përfaqësues z.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1 Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Tre Urat për personat që janë në marrëdhënie pune të fillojë procedurat për ti kaluar këta persona në Komisionin Disiplinor ku në varësi të përfshirjes së tyre dhe vlerës, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse,

sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013, nga “largim nga shërbimi civil” deri “mbajtja deri 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për punonjësit e mëposhtëm:

1. z. [REDAKTUAR], me detyrë doganier pikë hyrje/peshore/parkim doganor në Degën e Doganës Tre Urat, për të meta e mangësi sipas procesverbalit të KLSH ,nr. 4, datë 05.11.2014;
2. z. [REDAKTUAR], me detyrë doganier pikë hyrje/peshore/parkim doganor në Degën e Doganës Tre Urat, për të meta e mangësi sipas procesverbalit të KLSH, nr. 4, datë 05.11.2014.

(Trajtuar hollësisht në faqet nr. 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.2. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Tre Urat që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda dhe të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “ç”, “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. z. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale ish-sekretar/arkiv/magazinë në Degën e Doganës Tre Urat, aktualisht me detyrë funksionale doganier klasifikim/vlerë në Degën e Doganës Kakavie për mos ushtrim për asnjë ditë të detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 14.6 të “Rregullores së brendshme të degëve doganore”, Nr.19095/2 Prot. datë 12.11.2012, për të meta e mangësi sipas procesverbalit të KLSH, nr. 6, datë 07.11.2014.

(Trajtuar hollësisht në faqet nr. 16-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. z. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale sekretar/arkiv/magazinë në Degën e Doganës Tre Urat, për mos ushtrim për asnjë ditë të detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 14.6 të “Rregullores së brendshme të degëve doganore”, Nr.19095/2 Prot. datë 12.11.2012, për të meta e mangësi sipas procesverbalit të KLSH, nr. 6, datë 07.11.2014.

(Trajtuar hollësisht në faqet nr. 16-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b. Neni 58 gërma “b”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për nëpunësin civil:

1. Për znj. [REDAKTUAR] me detyrë juriste/specialist borxhi/a-posterior në Degën e Doganës Tre Urat, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenet 14/4 dhe 14/5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- për problemet e konstatuara në konceptimin e vendimeve administrative në lidhje me klasifikimin e shkeljeve doganore, sipas procesverbalit të KLSH, nr. 1, datë 05.11.2014;

- për problemet e konstatuara në lidhje me procedurat e ndjekura për vjeljen e borxhit doganor, sipas procesverbalit të KLSH, nr. 2, datë 06.11.2014;

- për problemet e konstatuara në përmbushje të detyrave funksionale në lidhje me praktikat doganore trajtuar me keqklasifikim të kodit tarifor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor, sipas procesverbalit të KLSH, nr. 5, datë 06.11.2014 dhe aktverifikimit nr. 6, datë 07.11.2014.

(Trajtuar hollësisht në faqet nr. 35-36; 31-34 dhe 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për ish-punonjësit e poshtë cituar nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor.

1. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Kryetar i Degës Doganore, për 22 (njëzetë e dy) raste;

2. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier klasifikim/vlerë për 11 (njëmbëdhjetë) raste.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Agron Opari, p/grupi, Bashkim Shehu dhe Xhovan Domi, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës Tre Urat, Përmet nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra në zbatim të rekomandimeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT